

BIBLIOGRAFI
Nr. 11, datë 4.6.2021

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika “b”, në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, kreu II, neni 4, pika “a”, “c”, dhe në udhëzimin nr. 99, datë 13.4.2018, “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017, ‘Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr. 13, datë 3.5.2018, të kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 11, datë 4.6.2021, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. **Fashikull verifikimi nr. 323**, në ngarkim të **A.H.**, me 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

2. **Dosje pune dhe personale nr. 12611**, në ngarkim të **S.B.**, me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë në total. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”. Dosja i përket fondit ish-Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë.

KRYETAR I KOMISIONIT TË DEKLASIFIKIMIT DHE ZHVLERËSIMIT
Gentiana Sula